

**AKT I THEMELIMIT
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“SUNNY SKIES ENERGY” SH.P.K**

Sot më datë 6.7.2023 unë i nënshkruari:

1. Eni Zizolli, lindur në Haxhias, Elbasan, Shqipëri më datë 10.10.1995, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal **J51010071I**, me zotësi të plotë për të vepruar; me anë të këtij dokumenti themeloj një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, të quajtur **“SUNNY SKIES ENERGY” sh.p.k**, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 1 - Emërtimi

- 1.1 Themelohet një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar e emërtuar **“SUNNY SKIES ENERGY”** (në vijim e quajtur **“Shoqëria”**)
- 1.2 Shoqëria është themeluar sipas ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 **“Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”**, i ndryshuar si dhe fiton personalitet juridik në momentin e regjistrimit të saj ne Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.
- 1.3 Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, me Aktin e Themelimit dhe me statutin.

Neni 2 - Selia

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën Njësia Bashkiake nr. 5, Bulevardi **“Bajram Curri”**, Godina **“Agimi”**, Hyrja nr. 16, Apt. 288, Tiranë.

Shoqëria mund të hapë dege, zyra përfaqësie dhe të krijojë filiale në qytete të ndryshme të Republikës së Shqipërisë dhe/ose jashtë saj me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 3 - Objekti

Shoqëria ka për objekt veprimtaritë e mëposhtme:

- Studim, projektim, zbatim, prodhim dhe tregtim i energjisë elektrike nga burime alternative si sistemet fotovoltaike, parqet e erës, termocentralet, biomasa etj.
- Implementimi dhe menaxhimi i projekteve gjeneruese (fotovoltaike, eolike, hidrike) të energjisë elektrike, të cilat shfrytëzojnë burimet e rinovueshme të energjisë elektrike si dielli, era, uji si dhe i veprave të tyre ndihmëse. Përfshirë dhe pa u kushtëzuar vetëm në marrjen e të gjitha lejeve, licensave dhe autorizimeve paraprake/përfundimtare, institucionet përgjegjëse shtetërore (qofshin këto organe Qendrore apo Vendore), apo private të cilat mundësojnë zhvillimin e këtyre aktiviteteve në mënyrë të qetë dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
- Shitja me shumicë dhe pakicë e energjisë elektrike tek operatorët, furnizuesit, tregtarët, konsumatorët e energjisë elektrike (vendas apo të huaj), si dhëe në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike (ALPEX), apo Bursa të tjera të energjisë jashtë vendit.

Eni Zizolli


Përveç sa më sipër, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet q lidhet direkt ose indirekt, qe është rezultat ose lidhet me objektin e mësipërm. Pë arritjen e qëllimit të mësipërm, Shoqëria mund të kryejë çdo transaksion lidhur me pasuritëe luajtshme dhe të paluajtshme, dhe çdo aktivitet tjetër tregtar, financiar, qiraje ose hipotekë, që mund të konsiderohet i vlefshëm ose i nevojshëm në mënyrë që të ushtrohet objekti i Shoqërisë. Duke përfshirë por pa u kufizuar në linjat elektrike të tensionit të lartë dhe të mesëm, nënstacione elektrike dhe njësi të tjera të lidhjeve elektrike, rrugëve të aksesit etj., si dhe çdo aktivitet aksesor i lidhur me sa më sipër, si punime gërmimi, punime për prishjen dhe punime të tjera të tokës, punime civile, elektrike dhe mekanike të çdo lloji si dhe blerje, shitje, shkëmbim, import-eksport të pajisjeve, riparim dhe mirëmbajtje të materialeve dhe pajisjeve dhe të gjithë aktivitetet e lidhura me këto çështje, gjithashtu dhe në fushën e aktiviteteve të tregtimit.

Neni 4 - Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar Shqiptar për një periudhë kohore të pakufizuar. Asambleja e Ortakëve mund të shkurtojë kohëzgjatjen e Shoqërisë.

Neni 5 - Kapitali Themeltar

5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 10,000 Lek (dhjetë mijë lek), 1 kuotë me vlerë 10,000 lek.

Kapitali themeltar në para është nënshkruar nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë si më poshtë:

- Eni Zizolli, lindur në Haxhias, Elbasan, Shqipëri më datë 10.10.1995, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal **J51010071I**, me zotëi të plotë për të vepruar, zotërues i 1 kuote me vlerë 10,000 Lek që përfaqëson 100% të kapitalit themeltar të Shoqërisë;

5.2 Përgjegjësia e ortakëve për detyrimet e Shoqërisë ndaj të tretëve shtrihet deri në kufirin e kontributit të tyre në kapitalin e Shoqërisë.

5.3 I gjithë kapitali themeltar është nënshkruar dhe zotërohet tërësisht nga Ortakët e Shoqërisë.

Neni 6 - Administrimi


6.1 Shoqëria administrohet nga një Administrator i vetëm.

Administratori i vetëm:

- a) Mund të mos jetë ortak;
- b) Do të ushtrojë detyrën për një periudhë që do të përcaktohet kohë pas kohe nga Asambleja e Ortakëve në aktin e emërimit, e cila në asnjë rast nuk mund të jetë më e gjatë se 5 vite;

Detyrën e parë të Administratorit të Vetëm do ta ushtrojë z. Eni Zizolli, lindur në Haxhias, Elbasan, Shqipëri më datë 10.10.1995, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal **J51010071I**.

Administratori i Shoqërisë ushtron kompetencat e tij sic parashikohet nga dispozitat e ligjit.



Neni 7 - Viti Ushtrimor

Viti ushtrimor i shoqëisë fillon me datë 1 Janar dhe mbyllet me datë 31 Dhjetor të çdo viti. Pëjashtimisht, viti i parë ushtrimor fillon nga data e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe mbyllet më datë 31 Dhjetor 2023.

Neni 8 - Prishja dhe Likuidimi

Në rast prishje dhe likuidimi të Shoqërisë, për çfarëdo arsye dhe në çdo moment, Asambleja e Ortakëve do të emërojë likuidatorin ose likuidatorët në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 9 - Ligi i Zbatueshëm

9.1 Për sa nuk parashikohet në këtë Akt Themelimi, do t'i bëhet shprehimisht referencë Statutit të Shoqërisë dhe legjislacionit shqiptar në fuqi në fushën e shoqërive tregtare, veçanërisht ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar.

9.2 Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e këtij Akti Themelimi si dhe çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe ortakëve, apo midis vetë ortakëve, që nuk mund të zgjidhet në mirëkuptim midis tyre, do të zgjidhet nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Neni 10 - Të ndryshme

Ky Akt Themelimi i Shoqërisë është hartuar në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe, secila me vlerë të njëjtë, dhe nënshkruar rregullisht nga ortakët.



Tiranë, 6 Korrik 2023

**ORTAKU I VETËM THEMELUES I SHOQËRISË TREGTARE
“SUNNY SKIES ENERGY” sh.p.k**

ENI ZIZOLLI

Eni Zizolli

